

**NË EMER TË POPULLIT**

Gjykata e Apelit e Kosovës- Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare, Have Haliti dhe Driton Muharremi anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarve: M.B. nga Prishtina, A.S. nga Prizreni, për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo i autoritet zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1, 2.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe H.H. nga Suhareka, për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo i autoriteti zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1, 2.2 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prizren, ankesës së mbrojtësit të akuzuarit H.H. av. O.Z. dhe përgjegjës në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit M.B. av. H.ZH., përgjigjes në ankesën e të akuzuarit A.S., av. F.J. si dhe përgjigjes në ankesën av.O.Z., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prizren, PKR.nr.195/2015 datë 16.11.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK, me datën 22.05.2017, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I .Refuzohet, e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Prizren, ndërsa, aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prizren, PKR.nr.195/2015 i datës 16.11.2016, sa i përketë pjesës liruese, vërtetohet.

II. Me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të akuzuarit H.H., aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prizren PKR.nr.195/2015 i datës 16.11.2016, ndryshohet, në pjesën gjyquese, ashtu që Gjykata e Apelit, konform nenit 364 par. 1 pika 1.3 të KPPK-së, të akuzuarin H.H., e

**LIRON NGA AKUZA**

Se më dt. 10.10.2011, si person zyrtar në cilësinë e zyrtarit për buxhet dhe financa dhe ushtrues i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm në Universitetin e Prishtinës, duke i shfrytëzuar detyrat zyrtare dhe autorizimet e tija, me dashje dhe me dijeni nuk i përmbush detyrat zyrtare të tija, me qëllim të shkaktimit të demit dhe shkeljes serioze të drejtave të dëmtuarit E.S., (profesor) si dhe shkel ligjin lidhur me detyrat e punësimit dhe nuk i kryen detyrat e domosdoshme të përcaktuara me ligj, në atë mënyrë që edhe përkundër se i dëmtuari kishte kontratë pune të lëshuar nga Universiteti i Prizrenit prej dt. 10.06.2011, si prorektor i Universitetit të Prizrenit, deri më dt. 09.06.2014, i akuzuari H.H., ia ndërprente marrëdhënien e punës të dëmtuarit E.S., duke i marrë dhe nënshkruar dy vendime me numër, date dhe përmbajtje të njëjtë, vendimet nr.01-624 të dt. 10.10.2011, njërin vendim e nënshkruan në emër të tij, ndërsa tjetrin vendim në emër të rektorit M.B..

-me këtë kishte për të kryer veprën penale keqpërdorim i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1, 2.2 të KPRK-së, meqenëse nuk është provuar se i akuzuari kanë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

I dëmtuari E.S., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Prizren, PKR.nr.195/2015 të datës 16.11.2016, i akuzuari H.H., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1, 2.2 të KPRK-së, dhe i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari mbrenda afatit prej 2 (dy) viteve, nuk kryen veprën tjetër penale.

Të akuzuarit i është shqiptuar dënimi plotësues, ndalim i ushtrimit të funksioneve në administratën publike apo shërbimeve publike në kohëzgjatje prej 2 viteve.

I akuzuari H.H., është obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, kurse në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 400 (katër qind) €, në afat prej 15 ditëve, pas plotufqishmërisë së aktgjykimit.

I dëmtuari E.S., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në contest civil.

Të akuzuarit M.B. dhe A.S., për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo i autoritet zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1, 2.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, Konform nenit 364 par. 1 pika 1.3 të KPPK-së, janë liruar nga akuza, pasi që nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale e cila iu vihet në barrë sipas aktakuzës.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesa kanë ushtruar:

Prokuroria Themelore - DKR në Prizren, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendje faktike, shkelje të ligjit penal, sa i përket pjesës liruese të aktgjykimit, me propozim që Gjykata e Apelit, ta anulojë aktgjykimin e ankimuar për të akuzuarit M.B. dhe A.S., çështjen ta kthejë në rigjykim, kurse për të akuzuarit H.H., sa i përket vendimit për dënim, ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar, të akuzuarit H.H., t'i shqiptojë dënim me burgim efektiv apo me gjobë.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.H., av. O.Z., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendje faktike, shkeljes së ligjit penale dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarin ta lirojë nga akuza.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.B., av. H.ZH., në përgjigjen në ankesën e Prokurorisë, ka propozuar që të refuzohet ankesa e PTH-DKR në Prizren dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.S., av. F.J., në përgjigjen në ankesën e Prokurorisë, ka propozuar që të refuzohet ankesa e PTH-DKR në Prizren dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.H., av. O.Z., në përgjegjen në ankesën e Prokurorisë, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e PTH-DKR në Prizren.

Prokuroria e Apelit, me parashtresën PPA/I.nr.81/17 të dt. 21.02.2017, ka propozuar që të aprovohet ankesa e PTH-DKR në Prizren, ndërsa ankesa e mbrojtësit të akuzuarit H.H., dhe përgjigja në ankesën e mbrojtësve të akuzuarve M.B. dhe A.S. av. H.ZH. dhe av. F.J., të refuzohen si të pabazuara.

Konform nenit 390 të KPPK-së, Gjykata e Apelit, mbajti seancën e kolegjit, në të cilën nuk u njoftuan palët në procedure, sepse të akuzuarve nuk iu është shqiptuar denim me burgim efektiv.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, ankesat e Prokurorisë Themelore-DKR në Prizren, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit H.H., si dhe përgjigje në ankesën e Prokurorisë nga ana e mbrojtësve të akuzuarve M.B. dhe A.S., gjeti se:

Ankesa e prokurorisë është e pa bazuar, ndërsa ankesa e mbrojtësit të akuzuarit H.H., është e bazuar.

Prokuroria pretendon se aktgjykimi i ankimuar në pjesën liruese sa i përket të akuzuarve M.B. dhe A.S., të cilët gjykata e shkallës së parë, i ka liruar nga akuza në mungesë të provave është përfshirë në shkelje të dispozitave të nenit 370 të KPP-së, se gjykata e shkallës së parë, me rastin e marrjes së vendimit për lirim nga akuza nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike lidhur me veprën penale për të cilën janë akuzuar, arsyetimi i aktgjykimit liruës për të akuzuarit M.B. dhe A.S., është në kundërshtim të plotë me provat të cilat janë administruar, por gjykata e shkallës së parë, iu ka falur besimin e plotë deklaratave të akuzuarve, se i akuzuari M.B. ka qenë përgjegjës për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në pajtim me Ligjin e Universitetit Publik në Prizren, ka qenë në dijeni për statusin e secilit të punësuar, e në rastin konkret edhe të dëmtuarit E.S., kurse të akuzuarit A.S. dhe H.H., kanë qenë vartës të akuzuarit M.B.t, të cilët për punën e tyre i janë përgjigjur atij, se i akuzuari M. në cilësinë e rektorit ka qenë në dijeni për veprimet e të akuzuarve, andaj, gjykata provat të cilat i ka përmbajtur aktakuza, si dhe deklaratën e të dëmtuarit nuk e ka vlerësuar drejtë për vërtetimin e fakteve vendimtare, e që ka rezultuar me nxjerrjen e aktgjykimit liruës, me arsyetim se gjendja faktike në këtë çështje penale nuk është vërtetuar dhe provuar, se të akuzuarit M.B. dhe A.S., kanë kryer veprën penale si në aktakuzë, kjo shkelje ka ndikuar në marrjen e vendimit jo të drejtë.

Kurse mbrojtësi i të akuzuarit H.H., pretendon se me aktgjykimin e ankimuar janë shkelur dispozitat e procedurës penale të nenit 384 par. 1 pika 1.7, 1.8, 1.9 dhe 1.10 të KPK-së, dispozitivi i aktgjykimit ka kundërthënë me arsyetimin, se nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare, të cilat gjykatës i janë vënë në dispozicion. I dëmtuari

E.S., është emëruar prorektor dhe ka themeluar marrëdhënie pune në Universitetin e Prizrenit, me vendimin e Ministrisë së MASHT-it R.B. më dt. 06.05.2011. Mandati i prorektorit përfundon, me përfundimin e mandatit të rektorit, e cila është e paraparë me statutin e përkohshëm të Universitetit të Prizrenit. Sipas gjykatës së shkallës së parë, i akuzuari H.H., akuzohet për ndërprerjen e marrëdhënies së punës E.S. në cilësinë e prorektorit të Universitetit të Prizrenit, e cila kontratë e punës ka qenë e nënshkruar nga rektori themelues gjermani R.M. me mandat tre vjeçar, nga dt.10.06.2011 deri më dt. 09.06.2014, por sipas vendimit të Ministrisë së Arsimit, mandati i prorektorit përfundon njëkohësisht me atë të rektorit. Rektori i ri i zgjedhur më 01.10.2011, tani i akuzuari M.B., nuk e kishte propozuar të dëmtuarin E.S. për prorektor. I akuzuari H. në atë periudhë ka qenë i ngarkuar me punë shtesë, ushtrues i përgjithshëm i sekretarit të Universitetit të Prizrenit, kurse afati për paraqitjen e ndryshimeve në listën e pagave, ka qenë dt. 10.10.2011, atëherë i akuzuari në koordinim me rektorin M.B., ka nënshkruar për rektorin, vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës si prorektor, i cili vendim është mbështetur në akte juridike, sepse prorektori duhet të largohet si i tillë nga lista e pagave, për tu futur si profesor në bazë të thirrjes shkencore “Profesor i asociuar” të cilën ia kishte dhënë në ndërkohë Bordi i përkohshëm i Universitetit të Prizrenit, se nuk mundet në sistemin e pagave me figuruar i njëjti person në dy pozita. Formularin me të cilin prorektori largohet nga lista e pagave, e ka nënshkruar i akuzuari H.H., sepse e ka pasur nënshkrimin e autorizuar nga MASHT-i, për sistemin e pagave, në cilësinë e zyrtarit të autorizuar, por rektori i zgjedhur M.B.n, nuk e kishte ende të autorizuar nënshkrimin.

Sipas kësaj Gjykate, gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e ankimuar e ka përpiluar konformë dispozitave të nenit 370 par. 6 dhe 7 të KPPK, ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë arsyet për faktet vendimtare që kanë rezultuar nga provat e administruara si janë, dëshmitë e dëshmitarëve XH.D., F.SH., T.SH., provave materiale që gjinden në shkresat e lëndës. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse, ka paraqit arsye në të cilën është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështje juridike, me rastin e vërtetimit të mos ekzistimit të veprës penale për të akuzuarit M.B. dhe A.S. dhe me rastin e ekzistimit të veprës penale për të akuzuarin H.H., si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave ligjore, ndaj të akuzuarit H.H. dhe veprës së tij. Nga arsyet e paraqitura më lartë, kjo gjykatë gjënë, se janë të pa bazuar pretendimet e prokurorisë për pjesën liruese të aktgjykimit dhe pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit për pjesën gjyquese të aktgjykimit, se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Pretendimet për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria në ankesën, për të akuzuarit M.B. dhe A.S. nuk i ndan bazat ankimore, por të bazat ankimore, aktgjykimin e ankimon për vërtetimin të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ndërsa në arsyetim të ankesës me një fjali të vetme thotë se, gjykata e shkallës së parë në mënyrë jo të plotë dhe të gabuar ka vërtetuar gjendjen faktike.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.H. në ankesë pretendon se gjykata e shkallës e parë në mënyrë jo të plotë dhe të gabuar ka vërtetuar gjendjen faktike, sepse provat të cilat gjenden në shkesat e lëndës nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejtë, gjykata e shkallës se parë nuk i ka përfillur edhe të gjeturat e Inspektoriatit të Arsimit, ku konstatohet se vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës së E.S., më dt. 10.10.2011, me nr.01-624 është i ligjshëm, sepse sipas Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Prizrenit, mandati i prorektorit përfundon njëkohësisht me atë të rektorit, se i dëmtuari E.S. prej muajit tetor të vitit 2011 deri në 31.09.2013, kishte kërkuar pushim pa pagesë për dy vjet si mësimdhënës, e jo si prorektor.

Është i pabazuar argumenti i gjykatës se shkallës e parë, se i akuzuari H.H., nuk i ka përmbushur detyrat e tija zyrtare, me qëllim të shkaktimit të dëmit dhe shkeljes serioze të drejtave të dëmtuarit E.S., sepse E.S., nuk i është shkelur asnjë e drejtë, se të njëjtit i është lejuar pushimi pa pagesë për dy vjet nga rektori M.B., gjatë asaj kohe Universiteti i Prizrenit nuk ka pasur asnjë obligim ndaj tij. E kur E.S., i është dhënë thirrja e ligjërues “Profesor i asociuar”, i njëjti është futur në listën e pagave si ligjërues nga muaji tetor i vitit 2011, por me zero orë, për t’u mos u paguar, në këtë rast i akuzuari H.H. nuk ka bërë ndonjë shkelje, sepse kur punëtori nuk merr pagë edhe formalisht duhet të largohet nga lista e pagave dhe të kthehet përsëri kur plotësohen kushtet, kurse i akuzuari H. ka dhënë dorëheqje nga vendi i punës më 01 nëntor të vitit 2011 dhe nuk ka pasur kurrfarë përgjegjësie për pengimin e kthimit të tij në vendin e punës, pas skadimit të pushimit pa pagesë.

Sipas kësaj Gjykate, gjykata e shkallës se parë në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka konstatuar se i akuzuari M.B. si rektor, ndërsa A.S., si sekretar i përgjithshëm i Universitetit në Prizren, nuk kanë keqpërdorur detyrën zyrtare. Siç rezulton nga shkresat e lëndës i akuzuari M.B., me datën 1.10.2011 është emëruar si rektor i Universitetit Publik në Prizren, sipas statutit të UP të Prizrenit në momentin kur emërohet rektori i ri, ju pushon mandati edhe prorektorëve të emëruar më parë, ashtu që të akuzuarit M.B. dhe A.S., nuk e kanë larguar nga posti prorektorin E.S. me vullnetin e tyre, por është larguar nga pozita e prorektorit, sipas aktit më të lartë juridike dhe atë të statutit UP në Prizren.

Nga kjo që u tha më lartë pretendimet e prokurorisë se gjykata e shkallës e parë në mënyrë të gabuar ka vërtetuar gjendjen faktike, kur të akuzuarit M. dhe A.S. i ka liruar nga akuza, janë ë pa bazuara.

Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit H.H., se gjykata e shkallës se parë në mënyrë jo të plotë dhe të gabuar ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka gjetur se i akuzuari H.H. ka

keqpërdorur detyrën zyrtare, kur të dëmtuarit E.S. ja ndërprejnë marrëdhënien e punës, si prorektor, janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë, ka administruar provat e propozuara ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve të dëmtuarin E.S., dëshmitarët XH.D., F.SH. dhe T.SH., si dhe i ka administruar provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, kontratën e punës të lëshuar nga UPZ-ja më dt. 10.06.2011, sipas së cilës E.S., ka krijuar marrëdhënien e punës, si prorektor nga dt. 10.06.2011 deri më dt. 09.06.2014, vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës me nr.01-624 e dt. 10.10.2011, të lëshuar nga ushtruesi i detyrës së Sekretarit të përgjithshëm të Universitetit Publik të Prizrenit H.H., sipas të cilit vendim E.S. i është ndërprerë marrëdhënia e punës në cilësinë e prorektorit në çështjen mësimore më dt.10.10.2011, ku me të njëjtën datë i është lëshuar vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës por në emër të rektorit M.B., kurse të nënshkruar nga H.H., se të dy vendimit janë leshur me një datë dhe kanë përmbajtjen e njëjtë, por sipas të akuzuarit H. rektori nuk e ka pasur të deponuar nënshkrimin, sepse ka pasur vetëm 10 ditë sa e ka marrë detyrën e rektorit, për këtë arsye e ka nënshkruar në emër të tij. E.S. i është lejuar pushimi pa pagesë nga rektori M.B. në kohëzgjatje për dy vitesh, sipas vendimit nr. 01/461 datë 14.10 2011, si profesor.

Me vendimin e Inspektoratit të Arsimit, me nr.1014204 i dt. 16.08.2013, i nënshkruar nga H.A., në emër të Ekipit të Inspektorëve, është anuluar vendimi me nr.01-461 i dt. 14.10.2011, lidhur me lejimin e pushimit pa pagesë për periudhën dy vjeçare në emër të E.S., si dhe është anuluar vendimi me nr.01-472 i dt. 19.09.2011, lidhur me emërimin e E.S., profesor i asociuar për lëndët nga lëmia juridike.

I dëmtuari E.S. ka qenë në listën e pagave në pozitën e Prorektorit dhe ka realizuar të ardhura personale për muajin gusht dhe shtator, kurse për muajin nëntor të vitit 2011, nuk ka figuruar në listën e pagave, sepse nuk ka pasur as një ditë punë.

Me vendimin e Inspektoratit të Arsimit në Prizren, E.S., nuk i mundësohet realizimi i pushimit pa pagesë në kohëzgjatje prej 2 vjetëve, pranë Universitetit Publik në Prizren, në cilësinë e ruajtjes së vendit të punës, si mësimdhënës -profesor i asociuar në lëmin juridike.

Nga të gjitha provat e administruara, dëgjimit të dëshmitarëve si dhe nga mbrojtja e të akuzuarve, nuk është kontestuese se i dëmtuari E.S., më dt. 10.06.2011, ka themeluar marrëdhënien e punës në Universitetin e Prizrenit, për periudhën deri më dt. 09.06.2014, kurse më dt. 19.09.2011, E.S. është emëruar profesor i asociuar për periudhën katër vjeçare. Më dt. 14.10.2011, me kërkesën e E.S. rektori M.B. e ka liruar pa pagesë nga mësimdhënia për periudhën dy vjeçare, kurse më dt. 10.10.2011 i akuzuari H.H., ka nxjerr dy vendime me numër, datë dhe përmbajtje të njëjtë, njërin e ka nënshkruar si

ushtrues i detyrës së sekretarit të përgjithshëm ndërsa, vendimi tjetër në emër të rektorit M.B..

Se nuk është kontestuese se më dt. 16.08.2013, ekipi i Inspektorëve të Arsimit, e anulon vendimin lidhur me lejimin e pushimit pa pagesë për periudhën dy vjeçare në emër të E.S., kurse duke vepruar sipas ankesës së E.S., Drejtori i Departamentit të Inspeksionit më dt. 28.08.2013, refuzon ankesën e E.S. dhe e mbështetë vendimin e Inspektorëve të Arsimit të dt. 16.08.2013, me arsyetim se lejimi i pushimit pa pagesë në periudhën dy vjeçare për E.S. si profesor i asociuar është i kundërligjshëm. Sekretari i Përgjithshëm i MASH-it duke vepruar sipas ankesës së E.S. më dt. 11.10.2013, pjesërisht e aprovon ankesën e E.S., të ushtruar kundër vendimit të Drejtoratit të Departamentit të Inspeksionit në MASH, të dt. 22.08.2013, dhe lënda kthehet në rishqyrtim te Drejtoria e Departamentit të Inspeksionit.

Se vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës E.S. ka qenë i ligjshëm, ngase, mbështetet në nenin 4 të Statutit të Universitetit Publik në Prizren, i cili parasheh se mandati i prorektorëve përfundon njëkohësisht me atë të rektorit.

Pas vlerësimit të gjitha provave të administruara, kjo gjykatë gjen se, gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka konkluduar se është vërtetuar gjendja faktike, kur ka gjetur se i akuzuari H. H ka kryer veprën penale keqpërdorim i pozitës apo i autoritet zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1, 2.2 të KPRK-së.

Si u tha më lartë për të akuzuarit M.B.n dhe A.S., sipas statutit të UP në Prizren, prorektorët ndajnë fatin e rektorit, në momentin kur rektorit i pushon mandati, automatikisht edhe prorektorëve ju pushon mandati, kështu që pushimi i mandatit të prorektorit për E.S., nuk ka qenë i varur nga i akuzuari H.H., por nga statuti i Universitetit, prandaj gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të gabuar ka konkluduar se i akuzuari H.H. ka keqpërdor pozitën apo i autoritet zyrtar, kur ja ka ndërprerë marrëdhënien e punës si prorektor E.S., si dhe e ka larguar nga lista e pagave, se vendimin e ka marrë sipas statutit të UP.

Vërtetimi jo i plotë dhe i gabuar i gjendjes faktike në aktgjykimin e ankimuar ka sjellë deri tek shkelja e Ligjit Penal nga neni 385 par.1 të KPPK-së. Gjykata e shkallës së parë, ka shkelur Ligjin Penal në dëm të akuzuarit H.H., kur ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale keqpërdorim i pozitës apo i autoritet zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1, 2.2 të KPRK-së. Si u konstaua më lartë, me provat që janë administruar e që gjinden në shkresat e lëndës nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer vepër penale, sepse me vendimin e MASHT-it çështja është kthyer në rishqyrtim në Drejtoratin e Inspektorit të Arsimit, të cilët e kanë anuluar vendimin e Universitetit të Prizrenit, andaj në veprimet e të akuzuarit H. nuk manifestohen elementet e veprës penale keqpërdorim i pozitës apo i autoriteti zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1, 2.2 të



KPPK-së, për të i mënjeluar shkeljet e ligjit penal në dëm të akuzuarit H.H. aktgjykimi për pjesën dënuese u ndryshua dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqë, nuk është provuar se i akuzuari H. H, ka kryer veprën keqpërdorim i pozitës apo i autoritet zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1, 2.2 të KPRK-së,. për të cilën është akuzuar, kjo gjykatë të njëjtin në mungesë të provave e liron nga akuza konform neni 364 par.1 nënpar.1.3 të KPPK-së.

Sa i për ketë pjesës liruese të aktgjykimit, gjykata e shkallës se parë, nuk ka gjetur prova se të akuzuarit M.B. dhe A.S. kanë kryer veprën penale keqpërdorim i pozitës apo i autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1, 2.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, andaj të akuzuarit me të drejtë i ka liruar nga aktakuza në mungesë të provave.

Nga çka u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimit në bazë të nenit 401 dhe neni 403 të KPPK-së.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

**PAKR.nr. 71/2017 me 22.05.2017**

**Procesmbajtësi,**

**Anëtarët e kolegjit**

**Kryetari i kolegjit**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Bujar Balaj**

**Have Haliti**

**Mejreme Memaj**

\_\_\_\_\_

**Driton Muharremi**

